



Në takimin e XVIII të Forumit Parlamentar të Cetinjës, “Gratë në Biznes”, të cilin e ka organizuar Parlamenti i Malit të Zi në bashkëpunim me OSBE-në (Organizatën Europiane për Siguri dhe Bashkëpunim), RCC (Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal) dhe GTF (Qendra Rajonale për Barazinë Gjinore), të mbajtur në Cetinjë më 8 dhe 9 qershor 2015, u miratua kjo,

DEKLARATË E PËRBASHKËT

Vendet anëtare të Forumit Parlamentar të Cetinjës kanë krijuar kuadrin juridik e institucional që mbështet barazinë gjinore, dhe bëjnë thirrje për përmirësimin e të drejtave të grave dhe fuqizimin ekonomik të grave.

Edhe pse kushtet formale janë krijuar, mungojnë ende si një mbështetje e plotë institucionale, ashtu edhe mekanizmat e përshtatëm nxitës, duke pasur parasysh se mbështetja për gratë afariste nuk është vetëm një çështje që i përket barazisë gjinore, por edhe një çështje e një rëndësie të veçantë për potencialin ekonomik të rajonit tonë.

Për këto arsye, pjesëmarrësit e takimit të XVIII të Forumit Parlamentar të Cetinjës bëjnë thirrje që të:

-promovohet rëndësia e afarizmit si për lulëzimin ekonomik të bashkësisë në tërësi, ashtu edhe për përmirësimin e pozitës personale ekonomike e familjare, për vënien në pah të aftësive personale dhe të rritjes së nivelit të autonomisë;

-themelohen rrjetëzime të grave në parlamente, në mënyrë që të fuqizohet roli mbikqyrës i parlamenteve mbi procesin e vënijes në jetë të politikave të barazisë gjinore;

-shfrytëzohen të gjithë kanalet e diplomacisë parlamentare, për të promovuar pjesmarrjen e grave në jetën ekonomike, vendimmarrjen në çështjet ekonomike dhe fuqizimin e afarizmit të grave;

-fillojë një bashkëpunim ndërmjet institucioneve, me të cilën institucionet do të kishim vizion të njëjtë në fushën e afarizmit të grave;

-përmirësohet mbajtja e statistikës për të pasur të dhëna të plota, si për hartimin e masave nxitëse, ashtu edhe për ndjekjen e zhvillimit të afarizmit të grave dhe të bëhet thirrje për hartimin e bazës së përgjithshme të të dhënave për afarizmin e grave, si në nivelin kombëtar shtu edhe në atë rajonal;

-mbështesë themelimin e fondeve për nxitjen e afarizmit të grave, por edhe të nxisë bashkëpunimin me bankat, të cilat duhet të jenë partnere në zhvillimin e afarizmit të grave;

-nxisë pushtetet lokale të hartojnë programe për mbështetjen e afarizmit të grave;



-nxisë ndërgjegjësimin për domosdoshmërinë e ndarjes së punëve dhe përgjegjësisë në sferën e jetës private e publike ndërmjet burrave dhe grave, të ngrëjë ndërgjegjësimin për përgjegjësinë prindërore të burrave, si dhe që të shtohet në vendet tona numri dhe kapaciteti i institucioneve për kujdesin për fëmijet dhe të moshuarit, të cilët i ofrojnë këto shërbime me çmime të arsyeshme;

-njohë rëndësinë e medijave, si partnerë të rëndësishëm për promovimin dhe përparimin e afarizmit të grave, dhe bëhet thirrje që me to të lidhet një bashkëpunim sa më i ngushtë;

-nxitjen, në procesin e afirmimit dhe të mbështetjes së afarizmit, të një bashkëpunim dhe partneritet sa më të ngushtë të sektorit publik me atë privat dhe joqeveritar;

-hartohen programe të ndryshme edukative për fillimin e biznesit privat, duke theksuar veçanërisht afarizmin e grave.

Deputetët dhe deputetet e vëndeve pjesëmarrësetë Forumit do të vazhdojnë të organizojnë takime për të shkëmbyer përvoja, për të identifikuar probleme dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e afarizmit të gruas si dhe për lobimin për projekte që do ti mbështesin.